

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e qarkut në Prizren, e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Tore Thomassen, si Kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Dean Pineles dhe gjyqtarja Raima Elezi si anëtarët e trupit gjykues, me procesmbajtësin Tarik Mripa, në lëndën penale ndaj **të pandehurve E.K dhe H.M**, të akuzuar në pajtim me aktakuzën PPS.nr.75/2010 të ushtruar nga Zyra speciale e prokurorisë të Republikës së Kosovës, Prishtinë të datës 30.03.2011 dhe pjesërisht të konfirmuar me datën 29.04.2011 (KA 76/11), për veprën penale **Krimet e luftës ndaj popullatës civile**, në pajtim me nenet 22 dhe 142 të kodit penal të Republikës socialiste federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tanimë të bërë penale me nenet 23 dhe 121 (1) të kodit penal të Kosovës (KPK) në lidhje me nenin 3 të Përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe me nenin 13.2 të Protokollit II të 08.06.1977, Plotësues Konventave 1949 të Gjenevës (Protokolli plotësues II), dhe të **pandehurit Mu.H, Mi.H, N.H, N.B dhe J.K** të akuzuar me **dhënien e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i KPK**,

pas mbajtës së shqyrtimit kryesor të hapur me datat 28, 29, 30 qershor, 7, 26, dhe 27.07.2011, në praninë e prokurorit PSRK Maurizio Salustro; palët e dëmtuar, dëshmitarët D.B dhe S.B (me datat 28 dhe 29 qershor); dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar Jelena Nikolic nga DKR Beograd (me datat 26 dhe 27 korrik),

përfaqësuesi i të pandehurit E.K, avokati Ethem Rogova; i të pandehurit H.M, avokati Osman Zajmi; i të pandehurit Mu.H, avokati Gezim Kollgjaku; i të pandehurit Mi.H, avokati Xhavit Kreku; dhe i të pandehurit N.H, avokati Hajrip Krasniqi, dhe

pas këshillimit dhe votimit me datat 28 dhe 29 korrik dhe 2.08.2011 mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

1. I pandehuri **E.K**, emri i të atit ..., i lindur më në, tani me banim në, ka kryer shkollën e mesme, Kosovar, shqiptar, me gjendje të dobët financiare, në paraburgim që nga data 14.12.2010, **është fajtor**,

sepse në natën e datës 17 dhe në mëngjesin e hershëm të datës 18.07.1998, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të paidentifikuar të UÇK-s, zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të Oplotushes duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm të armatosur ndaj familjeve serbe në fshatin në fjalë.

Prandaj i pandehuri E.K ka kryer në bashkë-kryerje veprën penale **Krimet e luftës ndaj popullatës civile**, në pajtim me nenet 22 dhe 142 të kodit penal të Republikës socialiste federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tanimë të bërë penale me nenet 23 dhe 121 (1) të kodit penal të Kosovës (KPK) në lidhje me nenin 3 të Përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe me nenin 13.2 të Protokollit II të 08.06.1977, Plotësues Konventave 1949 të Gjenevës (Protokolli plotësues II).

E.K **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 142 të KPRSFJ për periudhën e burgimit prej pesë (5) vitesh, në të cilin dënim do të merret parasysh koha e kaluar në paraburgim nga data 14.12.2010.

2. I pandehuri **H.M**, emri i të atit ..., i lindur më në ..., tani me banim në, zdrukthëtar, ka kryer shkollën fillore, Kosovar, shqiptar, me gjendje të dobët financiare, në paraburgim që nga data 14.12.2010, **lirohet**,

sepse në pajtim me nenin 390 3) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK) nuk është dëshmuar se ai ka kryer veprën me të cilën akuzohet, do të thotë se në natën e datës 17 dhe në mëngjesin e hershëm të datës 18.07.1998, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s, ai nuk zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të Oploterushes sepse nuk mori pjesë në sulmin e qëllimshëm te armatosur ndaj familjeve serbe në fshatin në fjalë.

Prandaj i pandehuri H.M nuk ka kryer në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s veprën penale **Krimet e luftës ndaj popullatës civile**, në pajtim me nenet 22 dhe 142 të kodit penal të Republikës socialiste federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tanimë të bërë penale me nenet 23 dhe 121 (1) të kodit penal të Kosovës (KPK) në lidhje me nenin 3 të Përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe me nenin 13.2 të Protokollit II të 08.06.1977, Plotësues Konventave 1949 të Gjenevës (Protokolli plotësues II).

3. I pandehuri **Mu.H**, emri i të atit ..., emri i nënës ..., i lindur më ... në ..., ..., ka kryer shkollën fillore, punon si zdrukthëtar, shqiptar, **është fajtor**,

sepse i ndihmoi E.Kt (nën hetime për krimin Krimet e luftës ndaj popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të fshatit Oploterushë duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm te armatosur ndaj familjeve serbe që ndodheshin në fshatin në fjalë) duke dhënë deklaratë të rrejshme të dëshmitarit në mbështetje të alibisë mbrojtëse të E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së hetimeve të krimeve të luftës së EULEX-it në fshatin Rogove me datën 23.02.2011, ai deklaroi rrejshëm se E.K ishte plagosur në fillim të muajit korrik 1998.

Prandaj i pandehuri Mu.H i ndihmoi E.Kt pas kryerjes së veprave penale për të cilat E.K është gjetur fajtor, të paraparë dhe të dënueshëm me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës.

Mu.H **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës me gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtim me nenet 43-44 të KPK dënimi pezullohet, nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës prej një (1) viti.

4. I pandehuri **Mi.H**, emri i të atit ..., emri i nënës ..., i lindur më në ..., ..., ka kryer shkollë e mesme, punon si zdrukthëtar, shqiptar, **është fajtor**,

sepse i ndihmoi E.Kt (nën hetime për krimin Krimet e luftës ndaj popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të fshatit Opterushe duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm të armatosur ndaj familjeve serbe që ndodheshin në fshatin në fjalë) duke dhënë deklaratë të rrejshme të dëshmitarit në mbështetje të alibisë mbrojtëse të E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së hetimeve të krimeve të luftës së EULEX-it në fshatin Rogove me datën 23.02.2011, ai deklaroi rrejshëm se E.K ishte plagosur në fillim të muajit korrik 1998.

Prandaj i pandehuri Mi.H i ndihmoi E.Kt pas kryerjes së veprës penale për të cilën E.K u gjet fajtor, të paraparë dhe të dënueshëm me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës.

Mi.H **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës me gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtim me nenet 43-44 të KPK-se dënimi pezullohet, nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës prej një (1) viti.

5. I pandehuri **N.H**, emri i të atit ..., emri i nënës ..., i lindur më, ..., ka kryer shkollën fillore, pronar i kafenesë, shqiptar, **është fajtor**,

sepse i ndihmoi E.Kt (nën hetime për krimin Krimet e luftës ndaj popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të fshatit Opterushe duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm të armatosur ndaj familjeve serbe që ndodheshin në fshatin në fjalë) duke dhënë deklaratë të rrejshme të dëshmitarit në mbështetje të alibisë mbrojtëse të E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së hetimeve të krimeve të luftës së EULEX-it në fshatin Rogove me datën 3.03.2011, ai deklaroi rrejshëm se E.K ishte plagosur në fillim të muajit korrik 1998.

Prandaj i pandehuri N.H i ndihmoi E.Kt pas kryerjes së veprës penale për të cilën E.K u gjet fajtor, të paraparë dhe të dënueshëm me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës.

N.H **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës me gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtim me nenet 43-44 të KPK

dënimi pezullohet, nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës prej një (1) viti.

6. I pandehuri **N.B**, emri i të atit ..., emri i nënës ..., i lindur më ..., ..., ..., diploma e fakultetit ekonomik, shqiptar, **është fajtor**,

sepse i ndihmoi E.Kt (nën hetime për krimin Krimet e luftës ndaj popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të fshatit Opterushe duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm të armatosur ndaj familjeve serbe që ndodheshin në fshatin në fjalë) duke dhënë deklaratë të rrejshme të dëshmitarit në mbështetje të alibisë mbrojtëse të E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së hetimeve të krimeve të luftës së EULEX-it në fshatin Rogove me datën 3.03.2011, ai deklaroi rrejshëm se E.K ishte plagosur në fillim të muajit korrik 1998.

Prandaj i pandehuri N.B i ndihmoi E.Kt pas kryerjes së veprës penale për të cilën E.K u gjet fajtor, të paraparë dhe të dënueshëm me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës.

N.B **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës me gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtim me nenet 43-44 të KPK-se dënimi pezullohet, nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës prej një (1) viti.

7. I pandehuri **J.K**, emri i të atit ..., emri i nënës ..., i lindur më ..., në ..., tani banon në ... ku ligjëron në universitet, shqiptar kosovar, **është fajtor**,

sepse i ndihmoi E.Kt (nën hetime për krimin Krimet e luftës ndaj popullatës civile, sepse në bashkë-kryerje me ushtarët e tjerë deri tani të pidentifikuar të UÇK-s zbatoi masat e frikës dhe terrorit ndaj popullatës civile serbe të fshatit Opterushe duke marrë pjesë në sulmin e qëllimshëm të armatosur ndaj familjeve serbe që ndodheshin në fshatin në fjalë) duke dhënë deklaratë të rrejshme të dëshmitarit në mbështetje të alibisë mbrojtëse të E.Kt, më konkretisht, kur u dëgjua në cilësinë e tij si dëshmitar nga oficerët e Njësisë së hetimeve të krimeve të luftës së EULEX-it në fshatin Rogove me datën 8.03.2011, ai deklaroi rrejshëm se E.K ishte plagosur në fillim të muajit korrik 1998.

Prandaj i pandehuri J.K i ndihmoi E.Kt pas kryerjes së veprës penale për të cilën E.K u gjet fajtor, të paraparë dhe të dënueshëm me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës.

J.K **dënohet** si në vijim: në pajtim me nenin 305 paragrafi 2 i Kodit penal të Kosovës me gjashtë (6) muaj burgim. Në pajtim me nenet 43-44 të KPK-se dënimi pezullohet, nëse personi i dënuar nuk kryen edhe ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës prej një (1) viti.

8. Secili nga personat e dënuar do të – një për të gjithë dhe të gjithë për një – do të dëmshpërblejnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) i

KPPK me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shpenzimet do të merret nga gjykata kur kjo e dhënë të merret në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) i KPPK.

9. Gjithashtu **E.K** do të mbuloj shpenzimet shtesë të arrestimit dhe të shoqërimit.

10. **E.K dhe H.M** do të lirohen nga paraburgimi me që kushtet e nenit 281 paragrafi (1) nënparagrafi 2) i KPPK nuk janë plotësuar.

11. **Paditë pronësore** do të trajtohen me padinë e veçantë civile.

ARSYETIMI

I. Rrjedha procedurale

Me datën 20.12.2007 gjykata e qarkut në Beograd i pushoi akuzat ndaj S.M për veprën penale të Krimeve të luftës ndaj popullatës civile në Opterushe më 17.-21.7.1998. Me datën 3.3.2009 Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë hodhi poshtë aktgjykimin dhe e ktheu prapa lëndën gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Me datën 19.8.2010 kreu i Zyrës së prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) lëshoi një kërkesë Serbisë për urdhër arrestin dhe materialet dëshmuese lidhur me të në lëndën e S.M.

Me datën 20.8.2010 prokurori publik i PSRK lëshoi aktvendimin për fillimin e hetimeve ndaj S.M për veprën penale të Krimeve të luftës ndaj popullatës civile në Opterushe më or rreth datës 18.7.1998.

Me datën 29.11.2010 zëvendës prokurori i krimeve të luftës i Republikës së Serbisë njoftoi prokurorin publik të PSRK se për shkak të rrethanave mirë të njohura politike të tanishme as ai, procesmbajtësi dhe as ndonjë nëpunës tjetër i gjykatës është në gjendje të vjen dhe të dëshmojë në Kosovë në hetimet ndaj S.M në cilësinë e tyre zyrtare.

Me datën 30.11.2010 prokurori publik i PSRK lëshoi aktvendimin për zgjerimin e hetimeve ndaj E.Kt, S.Bt dhe H.Mt për veprën penale të krimeve të luftës ndaj popullatës civile në Opterushe në ose rreth datës 18.7.1998.

Me datën 1.12.2010 prokurori publik i PSRK lëshoi aktvendimin për pushimin e hetimeve ndaj S.M.

Me datën 14.12.2010 oficerët policor i Njësisë për hetimin e krimeve të luftës (NJHKL) arrestuan E.Kn dhe H.Mn.

Me datën 14.12.2010 gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendimin për paraburgim ndaj E.Kt dhe H.Mt për një muaj deri me datën 14.01.2011.

Me datën 21.12.2010 gjykata prej tre gjyqtarëve e gjykatës së qarkut në Prizren i hodhi poshtë ankesat ndaj aktvendimit.

Me datën 13.01.2011 kolegji prej tre gjyqtarëve i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendimin për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj deri me datën 14.03.2011. Me datën 21.01.2011 Gjykata supreme e Kosovës e hodhi poshtë ankesën e E.Kt ndaj aktvendimit.

Me datën 8.3.2011 prokurori publik i PSRK lëshoi aktvendimin për zgjerimin e hetimeve ndaj Mu.Ht, Mi.Ht, N.Ht, N.B dhe J.Kt për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.

Me datën 14.03.2011 gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendimin për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për një muaj deri me datën 14.04.2011.

Me datën 30.03.2011 prokurori publik i PSRK ushtroi aktakuzën (PPS 75/2010) në gjykatën e qarkut në Prizren ndaj E.Kt dhe H.Mt për veprën penale nën 1) Krimet e luftës ndaj popullatës civile në Opterüshe më 17. dhe 18.7.1998 dhe 2) Krimet e luftës ndaj popullatës civile në Opterüshe më 18.7.1998; dhe ndaj Mu.Ht, Mi.Ht, N.Ht, N.B dhe J.Kt për veprën penale dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.

Me datën 4.04.2011 kolegji prej tre gjyqtarëve i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendimin për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj deri më 4.06.2011.

Me datën 29.04.2011 gjyqtari i konfirmimit i EULEX-it, pas mbajtjes së shqyrtimit, pushoi akuzën nr. 2 ndaj E.Kt dhe H.Mt por konfirmoi akuzat e tjera. Me datën 09.06.2011 kolegji prej tre gjyqtarëve i gjykatës së qarkut në Prizren hodhi poshtë ankesat e E.Kt, Mu.Ht dhe Mi.Ht ndaj aktvendimit të konfirmimit.

Me datën 13.5.2011 prokurori publik i PSRK lëshoi aktvendimin për pezullimin e hetimeve ndaj S.Bt për arsye se nuk dihet vendndodhja e tij.

Me datën 2.6.2011 kolegji prej tre gjyqtarëve i gjykatës së qarkut në Prizren lëshoi aktvendimin për vazhdimin e paraburgimit ndaj E.Kt dhe H.Mt për dy muaj deri më 04.08.2011.

Me datën 28.06.2011 filloi shqyrtimi kryesor në gjykatën e qarkut në Prizren.

II. Provat e administruara

A. Dëshmitarët

1. D.B (pala e dëmtuar)
2. S.B (pala e dëmtuar)
3. A.B
4. F.M

5. P.M
6. N.M
7. A.H

B. Provat me shkrim

Gjykata i pranoi si provë dokumentet në vijim të cilat janë lexuar ose janë marr parasysh si të lexuara gjatë shqyrtimit kryesor:

Prokuror

1. Procedura e tregimit të fotografive dëshmitares D.B 26.10.2010
2. Procedura e tregimit të fotografive dëshmitares S.B 26.10.2010
3. Raporti policor 2.12.2010
4. Raporti policor 9.12.2010
5. Raporti policor 21.12.2010
6. Libri i regjistrimit i dorëzuar nga A. H NJHKL-s më 21.12.2010
7. Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit J.K më 8.2.2011
8. Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit Mu.H më 23.2.2011
9. Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit Mi.H më 23.2.2011
10. Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit N.B më 3.3.2011
11. Procesverbali i deklaratës së dëshmitarit N.H më 3.3.2011

E.K

12. Fotografia e masakrës që ndodhi në Rugovë 29.1.1999 (duke treguar qëllimisht praninë e djalit të D.B-it)

C. Dëgjimi i të pandehurve

1. E.K

2. H.M
3. Mu.H
4. Mi.H
5. N.H
6. N.B
7. J.K

Gjykata i pranoi si provë deklaratat në vijim të cilat janë marr parasysh si të lexuara gjatë shqyrtimit kryesor:

1. Deklaratat e E.Kt me datën 14.12.2010 dhe 24.1.2011
2. Deklaratat e H.Mt me datën 14.12.2010, 22.12.2010, 24.1.2011 dhe 11.2.2011
3. Deklaratat e Mu.Ht me datën 23.2.2011 dhe 14.3.2011
4. Deklaratat e Mi.Ht me datën 23.2.2011 dhe 14.3.2011

5. Deklaratat e N.Ht me datën 3.3.2011 dhe 17.3.2011
6. Deklaratat e N.B me datën 3.3.2011 dhe 17.3.2011
7. Deklaratat e J.Kt me datën 8.2.2011, 8.3.2011 dhe 15.3.2011

III Përmbledhja e fakteve të padiskutueshme

1. Se sulmi i armatosur nga njësitë e UÇK-s ndodhi në natën e 17 korrikut, dhe në mëngjesin e hershëm të datës 18.07.1998 në fshatin Opterushe (regjoni i Rahovecit).
2. Sulmi ishte i drejtuar ndaj shtëpisë në pronësi të familjes së dëshmitares D.B e cila në atë kohë shfrytëzohej nga shumica e familjeve serbe që jetonin në fshat. Gjatë sulmit, meshkujt serb kthyen zjarrin tek sulmuesit.
3. Pasi u krye sulmi në mëngjesin e 18 korrikut, rreth 15 serb nga shtëpia janë ngarkuar në rimorkion e traktorit dhe janë ngarë jashtë fshatit. Më vonë meshkujt serb janë ndarë nga femrat. Femrat serb i janë dorëzuar Kryqit të kuq pas dita ditëve. Meshkujt serb nuk janë parë kurrë më. Disa të mbetura nga meshkujt serb janë gjetur në një shpellë afër Klinës në muajin maj 2005.
4. I pandehuri E.K ishte pjesëtar i UÇK-s në kohën e sulmit, dhe të dy edhe ai edhe i pandehuri H.M jetonin në fshatin Opterushe në kohën e sulmit.

IV Faktet kontestuese

1. Te dy të pandehurit E.K dhe H.M mohojnë se kanë qenë të pranishëm dhe kanë marr pjesë në sulm më 17 dhe 18.07.1998 në Opterushe.
2. I pandehuri H.M nuk pranon se ka qenë pjesëtar i UÇK-s
3. Në çfarë shkalle serbët kanë qenë nën statusin e veçantë si civil, veçanërisht pse meshkujt në shtëpinë në fjalë kanë qenë të armatosur dhe kanë dhënë rezistencë gjatë sulmit.
4. Të pandehurit Mu.H, Mi.H, N.H, N.B dhe J.K mohojnë se kanë dhënë deklaratë të rrejshme gjatë intervistës nga hetuesit e EULEX-it përkitazi me kohën kur është plagosur i pandehuri E.K.

V Përmbledhja e gjendjes së dëshmuar faktike

1. Njësitë e UÇK-s , përfshirë njësitë nga Operushe dhe fshatrat përreth, sulmuan shtëpinë civile të D.Bit dhe familjen e saj në fshatin Operushe nga anët e ndryshme më 17 dhe 18.07.1998 me armë të armatosura. Të pranishëm në shtëpi gjatë sulmit kanë qenë gati të gjithë banorët serb të fshatit, gjithsej rreth 15 veta.
2. Meshkujt serb kthyen zjarr me pushkë dhe pistoleta gjatë sulmit.
3. Në mëngjesin e 18 korrikut familjet serbe hoqën dorë nga rezistenca e tyre dhe u dorëzuan UÇK-s. Menjëherë pas asaj oborri i shtëpive të Bosanic-ve u mbushën me ushtarët e UÇK-s.
4. Në mesin e ushtarëve që e mbushën oborrin ishte i pandehuri E.K dhe i pandehuri H.M.

5. Të pandehurit E.K dhe H. M të dy kanë qenë në fshatin Opterushe më 17 dhe 18.07.1998, ishin të armatosur, dhe mbanin uniformën dhe shenjën e UÇK-s.
6. I pandehuri E. K ishte i pranishëm jashtë shtëpisë serbe, prej mbrëmjes së datës 17 deri në mëngjesin e datës 18 korrik. Ai luajti rolin aktiv në sulm si komandant i njësisë së tij. Funkzionet e tjera të tij, lëvizjet dhe veprimet e hollësishme të datës 17 dhe 18 korrik janë të panjohura.
7. I pandehuri Ma ishte i pranishëm jashtë shtëpisë serbe, së paku në mëngjesin e 18 korrikut. Ai ishte kundër sulmit dhe e shprehi protestën e tij. Ai i la njerëzit nën komandën e tij dhe vetëm ai nga njësia e tij mori pjesë në sulm. Ai nuk shtëni as një të shtënë gjatë sulmit dhe e la vendin e sulmit pak kohë pasi sulmi u krye. Funkzionet e tij, lëvizjet dhe veprimet e hollësishme të datës 17 dhe 18 korrik janë të panjohura.
8. Të pandehurit Mi.H, N.H, N.B, dhe J.K kur u intervistuan si dëshmitarë të gjithë dhanë deklaratat e rrejshme hetuesve për datën kur ishte plagosur i pandehuri E.K, me qëllim që t'i sigurojnë alibinë mbrojtëse për Ka.

VI Provat lidhur me gjendjen e dëshmuar faktike

1. Të përgjithshme

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, gjykata shqyrtuese konstatoi se dëshmitë e dëshmitarëve dhe të palës së dëmtuar D.B dhe S.B në përgjithësi janë të besnike dhe të besueshme sepse ato i kanë përshkruar ngjarjet në mënyrë të ngjashme gjatë deklaratave të ndryshme të dhënë, dhe gjykata nuk sheh ndonjë arsye pse ato duhet të gënjejnë. Gjithashtu ato i kanë përshkruar ngjarjet me shumë hollësira. Rrjedhimisht gjykata i jep shumë rëndësi këtyre dëshmimeve, fillimisht të dhënë në gjykimin e hapur, por të plotësuar me deklaratat e tyre të mëhershme policisë/prokurorisë, përkundër deklaratave faktike të pasakta në disa pjesë të vogla, që gjykata konsideron se janë normale, sidomos duke marr parasysh se incidenti ndodhi para 13 vitesh.

Gjykata nuk konsideron deklaratat e dhëna në gjykatë nga ana e të pandehurve të besueshme për shkak të arsyeve të cekura më poshtë. Mirëpo, gjykata konsideron deklaratat e para të dhëna nga ana e të pandehurit H.M prokurorit të EULEX-it me datën 14 dhe 22.012.2010 në përgjithësi të saktë dhe të besueshme meqë kjo konfirmon dëshmitë e palës së dëmtuar dhe gjykata konsideron se nuk ka arsye pse ai do të gënjente përkitazi me ngjarjet e dhëna në këto deklarata.

2. Prania e E.Kt dhe H.Mt në datat 17 dhe 18 Korrik 1998

Njëra prej çështjeve kryesore faktike që duhet të merret parasysh nga gjykata është nëse te pandehurit E.K dhe H.M ishin të pranishëm në fshatin Opterushe gjatë sulmit te UÇK-s në datat 17 dhe 18 Korrik1998.

3. Dëshmitarja (dhe pala e dëmtuar) D.B

Në dëshminë e saj në shqyrtimin e datës 28.06.2011 (procesverbali prej faqes 13 e tutje), D.B përshkruan se rreth 15 persona serb ishin mbledhur në shtëpinë e tyre, edhe meshkuj edhe femra, të afërmit dhe fqinjët. Përveç dy personave tjetër serb, të gjithë personat serb në Opterushe ishin mbledhur në shtëpinë e Bo me datën 17.07.1998. Serbët ishin mbledhur për shkak të situatës së tendosur në fshat dhe meqë kishin parë disa ushtarë të UÇK-s duke kaluar andej pari prandaj nuk guxuan të shkojnë jashtë. Pas ndaljes së rrymës në shtëpi në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut, dhe të shtënat filluan drejt shtëpisë nga anët e ndryshme. Kur filluan të shtënat, femrat serb u urdhëruan nga meshkujt e tyre të shkojnë poshtë dhe të kërkojnë strehim në podrumin e shtëpisë.

Sipas D.Bit, në deklaratën e saj prokurorit publik me datën 26.10.2010, meshkujt serb në shtëpi kanë pasur në zotërimin e tyre pushkët dhe kthyen zjarrin pasi filluan të shtënat. Kjo është vërtetuar nga ajo gjatë shqyrtimit kryesor.

Pas marrjes në pyetje të tërthortë dhe duke marr parasysh të gjitha provat, nuk ka asnjë shenjë se meshkujt serb në shtëpinë në fjalë kanë pasur ndonjë armatim të rëndë në zotërimin e tyre, përveç pushkëve dhe pistoletave.

Më tej dëshmitarja deklaroi në gjykatë se ajo e njohte të dy të pandehurit E.Kn dhe H.Mn para sulmit të datës 17 korrik, sepse ata të gjithë ishin pjesëtarët e fshatit të njëjtë.

H.M gjithashtu ishte i njohur nga dëshmitaret me që ai, zdrukthëtari, i kishte montuar dyert në shtëpinë e tyre. H.M gjithashtu kishte vizituar shtëpinë disa ditë para sulmit dhe atëherë kishte pasur bisedë me burrin e saj për gjendjen e sigurisë në rast të konfliktit. Në rast të sulmit nga cilado palë në konflikt, ata do të mbronin njëri tjetrin.

E.K, ose "J" si thirrej rëndom, ishte gjithashtu i njohur për D.Bin si fqinj. Zëri i "J-s" ishte njohur gjithashtu nga burri i saj, N.B, si njeri i cili i thirri ata nga jashtë menjëherë para se të fillojë sulmi se burri i saj nuk duhej të del jashtë (Shqip: o D. mos dil, D. ishte si rëndom thirrej burri i saj, faqe 19 e procesverbalit të 28.06.2011).

Pasi serbët u dorëzuan në mëngjesin e 18.07.1998, sipas D.Bit, oborri i shtëpisë ishte mbushur me ushtarët e UÇK-s, në mesin e tyre E.K dhe H.M, të dy të veshur me uniforma të zeza të UÇK-s dhe të armatosur me pushkë (faqe 23 e procesverbalit të 28.06.2011). Ndonëse dëshmitarja ishte deri diku e paqartë se të pandehurit ishin të armatosur në dëshminë e saj në shqyrtimin kryesor, pas mendimit ajo konfirmoi atë çka i deklaroi prokurorit se të dy të pandehurit ishin të armatosur me pushkë derisa ishin të pranishëm në oborr menjëherë pas sulmit.

4. Dëshmia e dëshmitares S.B

Ajo gjithashtu konsiderohet si besnike dhe dëshmitare e besueshme në disa çështje kyçe, ndonëse ajo mund të ketë disa zbrazëtira në kujtesën e saj, si e sheh gjykata, për shkak të gjendjes së saj mjekësore. Ajo dëshmoi prokurorit publik më 27.10.2010 dhe dëshmia e saj në gjykimin e hapur duhet të vlerësohet me shpjegimin e saj të mëparshëm prokurorit. Nënkuptohej se jo të gjitha hollësitë paraqiten qartazi përkitazi me incidentin që ndodhi para 13 vitesh. Gjithashtu gjendja e saj e tanishme shëndetësore si rrjedhojë e sulmit, ka ndikuar në kujtesën e saj përkitazi me hollësitë e përpikta.

S.B, ndërkaq, vërteton, si edhe D.Bi, se të gjithë serbët në fshat ishin mbledhur në shtëpinë e Bo gjatë sulmit; se femrat shkuan në podrum kur filluan të shtënat; se meshkujt serb kthyen zjarr; se sulmi zgjati tërë natën derisa u dorëzuan dhe janë mbledhur në oborr; oborri u mbush me ushtarët e armatosur të UÇK-s me uniforma të zeza; dhe se ajo i njohu disa nga fshati i saj. Prokurorit publik me datën 27 Tetor 2010 asaj ia kujtua se kishte parë “J” në mesin e ushtarëve të UÇK-s në oborr në mëngjesin e 18 korrikut menjëherë pas sulmit.

Kur u pyet të vlerësoj numrin e ushtarëve të UÇK-s të cilët e mbushën oborrin në mëngjesin e 18 korrikut, S.B u përgjigj në gjykim:

“...mund të kishin qenë 2000 njerëz.”

Gjykata konsideron se ky vlerësim është tejet i zmadhuar dhe nuk e thekson atë. Mirëpo gjykata nuk merr parasysh se kjo shifër e pasaktë e deklaruar nga dëshmitarja, e nënvlerëson besueshmërinë e përgjithshëm të dëshmitares në çështjet kyçe. Gjithashtu gjykata merr parasysh se disa nga hollësitë e dhëna nga kjo dëshmitare duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike. Gjykata e bazon këtë në vështrimet e përgjithshme se jo gjithnjë dëshmitarët okularë japin deklarata të sakta në çdo hollësi, meqë edhe vështrimet edhe kujtesa mund të shkaktojnë disa pasaktësi. Gjithashtu gjykata e vë në pah faktin se kanë kaluar 13 vite që kur ndodhi sulmi dhe dëshmitarja jo vonë ka pasur sulm.

5. Foto identifikimi

Lidhur me dëshminë e saj prokurorit, dëshmitaret D.B dhe S.B e identifikuan “Jn” në foto-rreshtim, ndonëse e fundit me disa vështirësi. Avokatët mbrojtës e të pandehurve e kanë vënë në dyshim procedurën e këtij foto-identifikimi si shkelje të nenit 255.

Gjykata sek se sipas nenit 255, para foto identifikimit dëshmitarët së pari duhet të pyeten “të japin një përshkrim dhe të tregojnë tiparet dalluese” të personit. Kjo nuk ishte bërë. Në vend të asaj dëshmitaret në fund të deklaratës së tyre thjesht i është kërkuar të shikojnë një rend të 69 fotografive me ngjyra të meshkujve, dhe i pyetën nëse e njohin dike.

Dëshmitarja D.B e identifikoi të dy të pandehurit E.Kn dhe H.Mn në foto identifikimin e bërë me datën 26.10.2010.

Gjykata e konsideron këtë të dëshmuar mjaftë se dëshmitarja D.B e njikte të pandehurin J para sulmit dhe mundi mbi këtë prapavijë ta identifikoj atë.

Dëshmitarja S.B gjatë foto identifikimit të saj me datën 27.10.2010 e njohu të pandehurin E.Kn, por nuk e identifikoi të pandehurin H.Mn.

Në bazë të kësaj, procedura e përshkruar në nenin 255 paragrafi (1) nuk është ndjekur.

Ndonëse kjo është shkelje e nenit në fjalë, gjykata e konsideron atë si shkelje më të vogël nën rrethanat e tanishme dhe vë në pah veçanërisht për këtë:

1. Procedura e shënuar në nenin 255 (1) është në veçanti e rëndësishme aty ku dëshmitari duhet të identifikojë një person të panjohur. Mirëpo ky nuk ishte rasti me dy dëshmitaret meqë ato i identifikonin personat veç të njohura për to dhe të cilët veç i kishin përmendur me emra në deklaratat e tyre para se t'i tregoheshin 69 fotot.
2. Njëri prej kundërshtimeve më të rënda që rëndom ngritët kundër foto identifikimit është rreziku i sugjerimit, ose drejtimi i dëshmitarit drejt disa personit ose personave të caktuar. Me procedurën e bërë në këto rreshtime dhe faktit se kishte një mostër prej 69 fotografive, gjykata konsideron se nuk ka shenja të drejtimit të dëshmitarit drejt personave të caktuar.
3. Dëshmitarja D.B pranon se nuk e kishte parë të pandehurin J në 10 vitet e fundit para sulmit të datës 17 dhe 18.07.1998, dhe ka pasur disa vështirësi në identifikimin e tij në koleksionin e fotove prej 69 fotografi nha banorët e Opterushes.
4. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitarja D.B identifikoi të dy të pandehurit E.Kn dhe H.Mn

Në bazë të kësaj, foto identifikimi është vendosur si pjesë e pranueshme e dëshmisë gjatë shqyrtimit kryesor.

Në konstatimet përfundimtare të rrethanave të dëshmuara, gjykata merr parasysh foto identifikimin si pjesë e rëndësishme e dëshmisë.

6. Të pandehurit E.K dhe H.M

në gjykim të dy kanë mohuar marrjen pjesë në sulmin e datës 17 dhe 18 korrik.

6.1. H.M

Në deklaratën e tij prokurorit me datën 14.12.2010, H.M konfirmoi disa hollësi të deklaruara nga dëshmitarja D.B: se ai e njikte serbët që jetonin në Opterusha dhe se

kanë pasur marrëdhënie të zakonshme fqinjësore, se ai ishte zdrukthëtar dhe se i kishte montuar dyert në shtëpinë e Bo, se ai kishte vizituar shtëpinë e Bo pak para datës 17.07.1998 dhe kërkoi marrëveshje në rast të sulmit. Ma gjithashtu pranoi se me datën 17.07.1998 ishte në Opterushe dhe se ishte pjesëtar i UÇK-s dhe i ishte bashkuar UÇK-s para sulmit në Opterusha dhe se ai ishte udhëheqësi i njërit prej dy grupeve të UÇK-s në Opterusha, derisa E.K ishte udhëheqësi i grupit tjetër të UÇK-s në fshat. Ai gjithashtu deklaroi se nuk ka pasur marrëdhënie të mira midis dy grupeve të UÇK-s në Opterusha. Ai deklaroi se personalisht dhe me vet iniciativën e tij shkoi te të gjitha familjet serbe dhe diskutoi për tensionin në ngritje dhe se çka mund të bëhej për këtë rreth një ose dy javë para sulmit. Ai i paralajmëroi familjet se UÇK-ja nga Drenica do të vinte dhe do të trokiste në dyert e familjeve serbe dhe “do të bënte gjëra të tmerrshme, dhe se nuk mund të bëjmë asgjë për të penguar këtë.” Lidhur me këtë ai gjithashtu shkoi të vizitoj “D” ose M.B, burrin e dëshmitares D.B, i cili ishte mësues dhe një lloj i udhëheqësit të fshatit për serbët, për ta paralajmëruar për dëmet e mundshme dhe të ofroj ndihmën e tij në atë rast.

Në deklaratën e tij të datës 14.12.2010 H.M deklaroi se ai deshi të mbrojë çdokënd në fshat, përfshirë serbët dhe se ushtarët në grupin e tij e përkrahnin pikëpamjet e tij. Ai më tej deklaroi se pastaj erdhi urdhri i UÇK-s nga Drenica për të sulmuar serbët në fshat dhe për t'i detyruar t'i lëshojnë shtëpitë e tyre. Në faqe 5 të deklaratës nga data 14.12.2010, vazhdon si në vijim kur u pyet nga prokurori publik (PP):

HM: Ishte një njësi speciale e UÇK-s që erdhi nga Drenica për të marr pjesë në sulm ... unë i thashë komandantit të tyre, i cili mbante maskën:” Ku po shkoni, çka doni të bëni? Mundemi thjesht të shkojmë dhe të pimë kafe me serbët dhe të flasim me ata:” Por ai u përgjigj se kishte një urdhër dhe se duhej të vazhdonte. Prandaj unë i thashë pjesëtarëve të njësisë sime mos të marrin pjesë në operacion dhe se unë do të isha i vetmi që do të merrja pjesë në të, dhe se unë do të isha shumë i kujdesshëm rreth asaj se çka unë dhe të tjerët do të bënim.

PP: Çka ndodhi pastaj?

HM: Ishte natë. Unë isha në pjesën shqiptare të fshatit. Nuk shtënia. Isha pjesë e kësaj ofensive vetëm pse njerëzit thoshin se unë i mbroja

serbët. Nuk e ndoqa tërë operacionin. Zgjati rreth një ore por në një kohë unë shkova sepse nuk ndjeva se dua të vazhdoj pjesëmarrjen time në të.

PP: Si filloi sulmi?

HM: Në një kohë UÇK-ja thjesht hapi zjarr ndaj shtëpive serbe.

PP: A kthyen serbët zjarrin?

HM: Po.

PP: A ishte E. në njësinë tuaj a po në njësinë tjetër?

HM: Në tjetrin. Unë nuk kam pasur marrëdhënie të mira me të.

PP: A ishte ai pjesë e sulmit? A e keni parë atë atje?

HM: E pashë E në fshat, duke biseduar me njësinë speciale që erdhi nga Drenica pak para sulmit. Nuk e kam parë se ku e stacionoj E veten gjatë sulmit.

....

PP: A i keni parë ata në natën e sulmit?

HM: Jo. Si ju thashë, unë nuk ishe në mesin e grupit që shtëni, qëndrova anash, dhe në fakt jam kritikuar për shkak të asaj. Faktikisht unë mundohesha të fshehëm dhe mos të tregoj veten.

....

PP: A ka pasur ndonjë çast kur hytë në oborrin e shtëpisë serbe që ishte nën sulm?

HM: Jo

PP: Por a i keni parë kur ushtarët e tjerë të UÇK-s hyrën në oborr?

HM: Si thashë, një orë pasi filloi sulmi unë vendosa të shkoj në shtëpi. Sulmi vazhdoi deri në mëngjesin e ardhshëm. Në mëngjes, pjesëtarët e njësisë tjetër të UÇK-s erdhën në shtëpinë sime duke kërkuar vëllain tim për kamionin për të zhvendosur serbët për të nxjerrë jashtë fshatit. Vëllai im më pyeti dhe unë i thashë se unë nuk e lejoj atë. Pas një ore ata u kthyen dhe më kërkuan traktorin tim për të vënë gjërat e mara nga shtëpitë serbe. Edhe këtë e refuzova.

PP: A i keni parë serbët derisa shkonin nga fshati?

HM: Po. Shtëpia ime është në qendër të fshatit dhe ata kaluan menjëherë pranë saj. Ata ishin ngarkuar në traktor. Shkonin drejt fshatit të Samacraxhes. I pashë nga brenda shtëpisë, por ata nuk më panë mua. Nuk doja të shihesha sepse isha i turpëruar nga ajo çka ndodhte.

PP: A njohët ndokënd nga serbët?

HM: Po, ata ishin njerëzit nga fshati, ne zakonisht hanim dhe pinim bashkë. Ka pasur edhe disa femra.

PP: A dini nëse dikush u plagos gjatë sulmit?

HM: Nuk e di.

PP: A dini çka i ndodhi serbëve pastaj?

HM: Jo. Nuk mund të merrja informata as nga brenda UÇK-s, për shkak të marrëdhënieve të tendosura që kam pasur me ata.

.... ku më kanë thënë se kanë pasur urdhrin për të ma marr armën time. Më thanë se nuk jam aktivist i mirë. Pas një kohe, UÇK-ja erdhi përsëri dhe më mori, duke thënë se....kishte lëshuar urdhrin të më sjell me dhunë në selinë në Semetiste. UÇK-ja më mori dhe më qoi në Semetiste. Aty, një person i quajtur më mori në pyetje lidhur me qëndrimin tim ndaj UÇK-s dhe sjelljes brenda në UÇK. Ata më panë si një pengesë,

PP: A ka diçka që doni të shtoni?

HM: Vetëm dua të shtoj se si shihni jam i gatshëm t'ju tregoj të vërtetën por njëkohësisht jam i frikësuar nga njerëzit e tjerë, që mund të jenë armiqësor ndaj meje. Pres të ballafaqohem me vështirësi për shkak të deklaratave të mia me ju sot....”

Kur u intervistua me datën 22.12.2010 nga oficeri ndërkombëtar policor (ONP) këto mund të lexohen nga procesverbali:

“...

HM: Unë isha ushtar i UÇK-s dhe nëse doni të më dënoni pse kam qenë komandant atëherë bëjeni dhe mos e zvarriteni procesin, jam i pafajshëm dhe si thashë më herët i kam vizituar serbët para luftës dhe kemi biseduar se si mund të merremi dhe të ballafaqohemi me luftën. Ata ishin fqinjët e mijë dhe ne shkonim mirë....

....

ONP: Pas sulmit të shtëpive të serbëve me datë 18.07.1998 ai ishit ende në UÇK

HM: Jo, unë nuk isha as komandant para sulmit. Unë fare nuk kam qenë në UÇK pas sulmit. Të gjithë njerëzit në njësinë time dezertuan nga UÇK-ja gjithashtu pas asaj. UÇk-ja nuk funksiononte ashtu si duhej dhe ne nuk ishim të kënaqur me situatën.

ONP: Çka ishte ajo me çka nuk ishit të kënaqur

HM: Dhjetë ditë para sulmit, tre njerëz me maska mu afruan me një listë me 17 emra, ata trokitën në derën time dhe mbanin uniformat e zeza dhe maskat dhe unë i pyeta se çka donin dhe at më thanë se këta 17 persona duhet të sillen te ne gjallë a po vdekur, brenda 24 orësh. Unë kategorikisht i refuzova dhe i thashë se para se të bëjë këtë duhet të më mbysin në fillim. Akuzat ishin se ata ishin bashkëpunëtorët e serbëve dhe kjo nuk ishte e vërtetë.

ONP: Kush ishte emëruar në atë listë

HM: Është vështirë për mua të mbaj ndërmend të gjithë ata, por dhe disa djelmosha të rinj që ishin në listë tash nuk mund të rikujtoj, por kanë qenë gjithsej 17 emra. Ata më thanë se nëse nuk i përgjigjem për 24 orë ata do të kthehen sërish. I thashë se ata nuk kanë

se çka të kërkojnë nga unë, do të thotë se nuk isha i interesuar për këtë çështje. I tregova ta drejtojnë çështjen te komandant E "J" K. Pastaj më duhej të organizoj grupin tim për të më mbrojtur mua ose shtëpinë time dhe të identifikojë secilin që përpiquej të më afrohej por fatmirësisht askush nuk u përpiquej të më afrohet sërish, askush nuk erdhi. Atë ditë unë në njëfarë mënyre lajmërova për këtë vizitë tërë fshatit se duhet të ballafaqohemi me sfida të vështira dhe dikush mundohet të na bëjë kurthin.

ONP: Pse i quat te E.K

HM: Sepse ai ishte komandant dhe unë nuk isha. Unë vetëm mundohesha të mbroj veten dhe fqinjët e mijë.

ONP: A ishte kjo kur shkua në shtëpitë e serbëve

HM: Jo. ishte disa javë para kësaj kur shkova te serbët. Tensioni ishte i lartë në atë kohë dhe unë përpiquesha të mbroja bythën time. Ne kemi pasur marrëdhënie të mira.

ONP: Kush ishin njerëzit me maska

HM: Ishte ora 12 në mesnatë ose ora 1.00 në mëngjes prandaj nuk e di. Por i njoha disa figura dhe i dëgjova zërat e njëjta në natën e sulmit. Edhe tash nuk i di ata por besoj se ishte pjesë e sulmit. Disa orë para sulmit shkova ku ishin UÇK-ja të shohë nëse mund të marr përforcime, ata ishin ndërmjet Opterushes dhe fshatrave të Zocistes. Atje i pashë këta tre njerëz. I njoha dhe fola me ta. Ata më thanë se e dinin se kush jam unë. Nuk i kam parë të merrnin pjesë në sulm por besoj se kanë qenë pjesë të tij. Nuk e di se kush ishin, por ishin kundër popullatës shqiptare dhe kundër popullatës serbe. Ata ishin të veshur ushtarët e UÇK-s por nuk mund të quhen ushtarët e UÇK-s. Njëri prej tyre mu afrua në mënyrë të sjellshme, do të kishte qenë më mirë po ta kisha vrarë në vend.

IPO: Atëherë disa njerëz po ju kërkonin, a keni ende njerëz që ju kërkojnë.

HM: Jo, situata ka përfunduar tani. Me të mbaruar lufta nuk ka më arsye për këtë. Unë u kam thënë gjithnjë ushtarëve të mi të mos ndërmarrin veprime kundër civilëve. Ndërkohë u thashë se, edhe sikur babai im të vishte uniformë serbe, ju nuk mund ta qëlloni. Kur i pashë këta tre persona ndërmjet fshatrave Opterushë dhe Zociste, ata po i kërkonin çdo ushtari të UÇK-së të identifikohet. Ata më ndaluan dhe më thanë se duhet të shkoj me ta, sepse atje kishte ende rrezik, pasi kishte serbë. Unë refuzova dhe ata më thanë se nuk donin të merreshin me mua, pasi mund të më jepnin 2 plumba. Unë u thashë se nuk ishte qëllimi im të lëndoja civilët dhe ata thanë se nuk donin të dëgjonin mendimin tim. Unë u thashë se asnjë prej ushtarëve të mi nuk do të shkonte me ta. Pjesa e prapme ku ndodheshin shtëpitë serbe ishte tokë në pronësi të shqiptarëve dhe unë qëndrova atje, sepse sulmi po vazhdonte dhe pas një ore u arratisa dhe shkova në shtëpinë time.....

.....

IPO: Ju përmendët një nga..... fshati dhe më trego më shumë për të.

HM: Gjatë sulmit të serbëve kisha 20 plumba dhe nuk shkrepja as edhe një dhe kur shkova në shtëpi, tre ditë pas kësaj ata erdhën tek unë dhe njëri prej tyre ishte ... Ai më tha se isha frikacak dhe se nuk kisha shkrepur asnjë plumb dhe t'ia jepja armën atij dhe se ai do t'ua jepte trimave Pra, në thelb shkoja çdo ditë për të marrë armën time dhe në fund ata ma kthyen pas 7 ose 8 ditëve. Kur mora armën takova shokët e mi dhe u thashë se nuk doja të isha më pjesëtar i UCK-së....

.....

IPO: A folët me E.Kn ditën para sulmit ose në orët përpara sulmit?

HM: Po.

IPO: Për çfarë biseduat?

HM: Ai më tha se kishin ardhur disa persona të UCK-së dhe ata donin të sulmonin serbët

IPO: Kur thoni serbët, që të jemi të qartë, a e kishte ai fjalën për shtëpitë e civilëve serbë dhe serbët brenda tyre?

HM: Po, ishte e gjitha e planifikuar dhe gjithçka duhej të ndodhte shumë shpejt.

IPO: Të tjerët që ju thatë se ishin pjesë e njësisë së E.Kt, a ishin edhe ata prezent në orën përpara sulmit?

HM: Unë pashë vetëm En prezent dhe ne vetëm u kryqëzuam. Unë i thashë atij se nuk ma ndinte dhe se ai ishte përgjegjës për këtë fshat dhe se ai ishte ende komandant.

IPO: A u lëndua E.K gjatë luftës?

HM: U lëndua, por nuk u lëndua në fshat, informacion im është se ai u lëndua në rrugën nga Celina në Rugovë, kur u përfshi në një përleshje me një patrullë serbe.

IPO: Kur u lëndua?

HM: Pas ngjarjes në Opterushë në korrik 1998, por nuk jam i sigurt sepse nuk e ndoqa kurrë situatën, ndoshta brenda një muaji pas ngjarjes, por jo shumë kohë pas ngjarjes, me siguri.

IPO: A u lëndua ai kur biseduat me të në orët përpara sulmit mbi shtëpitë serbe në korrik 1998?

HM: Jo, ai ecte.

IPO: Kush jua dha juve gradën e komandantit?

HM: U vetë-shpalla komandant, sepse isha në grupin që mbronte shtëpitë. Pra, ne u organizuam dhe unë isha komandant. Nuk i përgjigjesha askujt. Ne mbronim pronën tonë private.

.....

IPO: A e njihni njësinë e UCK-së që sulmoi shtëpitë serben Opterushë, nga ishin?

HM: Nuk e di nga erdhën, por sipas dialektit të tyre ata nuk ishin nga fshati im ose nga regjioni..."

Më 24 janar 2011, kur u intervistua përsëri, i pandehuri H.M vërtetoi dëshmitë e mëhershme të tij, megjithëse e ndryshoi atë, për të zvogëluar rolin e tij, dhe mohoi pjesëmarrjen në sulm. Me këtë rast ai shtoi gjithashtu se, kur kishte vizituar shtëpitë serbe përpara sulmit, ai kishte parë

"shumë gjëra, por nuk doja të tregoja, deri tani askush tjetër nuk e pa këtë përveç meje, sepse unë e pashë me sytë e mi, serbët kishin armë të llojeve të ndryshme, të gjitha llojet e armëve, mitraloza të rëndë, bomba, armë anti-tank dhe radio. Askush tjetër nuk e dinte këtë, sepse nuk ia tregova njeriu tjetër këtë. Vetëm sytë e mi dhe Zoti i panë armët që kishin ata."

Në gjykatë ai vërtetoi deklaratën e fundit të tij në prokurori më 24 janar 2011, në të cilën mohoi pjesëmarrjen në sulmin mbi shtëpitë serbe.

Siç e sheh gjykata, deklaratat e H.Mt më 14 dhe 22 dhjetor 2010 duken të besueshme dhe gjykata nuk gjen arsye përse ai duhej të tregonte një ngjarje të ndryshme nga ajo që ndodhi, sigurisht përveç se të zvogëlojë rolin e tij, me qëllim që të trajtohet në mënyrë më të favorshme si i pandehur. Për më tepër, në përgjithësi dëshmia e tij përputhet me deklaratat e dy dëshmitareve, D.B dhe S.B , por jep përshkrim më të mirë, sigurisht, të asaj që ndodhi nga ana e sulmuesve.

Si përfundim, gjykata i gjen të besueshme deklaratat e H.Mt në datat 14 dhe 22 dhjetor 2010, përfshirë edhe rolin e tij në sulm, dhe nuk gjen arsye përse ai duhet të japë deklarata ose të tregojë ngjarje të rreme. Deklarata e tij e datës 24 janar 2011 është, megjithatë, më pak e besueshme, veçanërisht lidhur me rolin e tij në sulm. Informacioni i tij për armët e vërejtura në shtëpitë serbe nuk konsiderohet i besueshëm, veçanërisht sepse asnjë provë tjetër nuk tregon se serbët hapën zjarr me pushkë dhe/ose pistoleta pasi filloi sulmi dhe se ata u përgjigjën me zjarr, dhe po kështu duke marrë parasysh që ky informacion duket në deklaratën e Ma vetëm në janar 2011 dhe jo më përpara, dhe në rastin kur ai zvogëloi rolin e tij në sulm.

1.1. Dëshmitarja D.B

Deklaroi se e pa H.Mn në radhët e ushtarët që mbushën oborrin pasi serbët u dorëzuan në mëngjesin e datës 18 korrik, të veshur me uniformë, të armatosur dhe me një kapele bejsbolli të kthyer prapa.

Gjatë marrjes në pyetje më 28 qershor 2011, proces-verbali tregon ndër të tjera këto deklaratat (faqe 36) lidhur me të pandehurin H.M:

“...Osman Zajmi: Në mëngjesin e datës 18 korrik, në oborrin e shtëpisë tuaj kur njohët H, sa ishte largësia ndërmjet jush dhe tij?

D.B: Ndoshta pesë ose gjashtë metra. Ai nuk m’u afrua mua apo ndokujt, por kaloi përmes oborrit.“

Vetë Ma, megjithatë, në deklaratat e cituara më lart, pranon se ishte prezent në sulm dhe gjatë sulmit për rreth një orë, përpara se të largohej dhe të shkonte në shtëpi.

Bazuar në këtë, gjykata gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri H.M ishte i armatosur dhe i veshur me uniformë në radhët e ushtarëve që sulmuan shtëpinë serbe në mëngjesin e 18 korrikut për rreth një orë, pa shtënë as edhe një herë, përpara se të shkonte në shtëpi. Po kështu, gjykata gjen të provuar mjaftueshëm se ai e kundërshtoi fuqimisht sulmin dhe nuk ishte veçanërisht aktiv, siç përshkruhet më tutje në deklaratat e tij – të lart-përmendura – të 14 dhe 22 dhjetorit 2010

2. E.K

E.K e ka mohuar pjesëmarrjen në sulmin e 17 dhe 18 korrikut 1998, pasi ishte plagosur në betejë rreth një muaj përpara se të ndodhte sulmi.

Në deklaratën e tij në prokurori më 14 dhjetor 2010, që ai e mbrojti në gjykatë, ai deklaroi se ishte pjesëtar i UCK-së, në të cilën u kyç në mars 1998 në Drenicë. Ai mori postin e komandantit të kompanisë në fund të nëntorit 1998 dhe mohon ta ketë pasur këtë post në korrik 1998. Megjithëse është nga Opterusha, ai mohon ta ketë pasur bazën e UCK-së në Opterushë, por në vend të kësaj ka qenë *“në grupin e UCK-së në Drenovë, por jo në të njëjtin grup me fshatarët e tjerë nga Opterusha.”* Më tej ai deklaroi se nuk di gjë për këtë sulm në Opterushë nga fundi i korrikut.

Për më tepër, ai shpjegoi se ishte lënduar rreth një muaj para 17 korrikut dhe në kohën e sulmit më 17 dhe 18 korrik po trajtohej për plagën e tij.

3. Alibia e E.Kt

E.K deklaroi në prokurori më 14 dhjetor 2010, dhe mbrojti në gjykatë gjatë shqyrtimit kryesor, se ishte

“plagosur më 11 korrik 1998 në rrugën kryesore Gjakovë-Prizren afër një fshati të quajtur Rugovë e Hasit, komuna e Gjakovës.

PP: Si ndodhi?

EK: Atje u bë një betejë e cila zgjati 10-15 minuta. Ishim vetëm ne të dy, J.K, i cili voziste, dhe unë. Ishim në një automjet civil Golf I ose II të bardhë dhe një xhip i blinduar erdhi në drejtimin tonë. Ata ishin policë dhe ushtarakë me uniformë. Unë hapa zjarr kundër tyre me AK-47 nga një distancë prej 10 metrash. Kerri ynë ishte në lëvizje ndërkohë që hapa zjarr. Shoku im nuk qëlloi. Unë qëllova nga dritarja, u mbështeta jashtë dritares së kerrit dhe hapa zjarr. Atje ka dy ura në largësi 150 metra. Në ecëm mbrapsht në ato 150 metra deri në kryqëzimin për në fshatin Rugovë. Pas një shkëmbimi të madh zjarri me njerëzit në Xhip, na qëlluan edhe nga prapa. Një plumb goditi kerrin tonë dhe më goditi në shpinë. Kur u plagosa, kerri ishte ende duke lëvizur prapa. Plumbi hyri nga dera e prapme në anën e vozitësit, goditi ulësen e prapme, ulësen e parme dhe më goditi mua. Nuk arrita ta shoh kush më qëlloi...

....

PP: A shkuat në spital?

EK: Mora ndihmën e parë nga një mjek në Rugovë të Hasit. Nuk më kujtohet emri i tij, por ai vdiq para disa kohësh. U mjekova në shtëpinë e një farë S.G. Ai jeton ende në Rugovë. Pas disa orëve, shkova në spital në Gajrak. Ai është një fshat afër Pagarushës. Atje ishte një spital ushtarak i UCK-së. Atje, një mjek me emrin A. Ha ma mjekoi plagën. Tani ai punon në spitalin e Prizrenit ... Qëndrova 15 ditë në spital. Nuk më kujtohet data, por në një moment spitali u zhvendos për shkak se po vinte një mësymje serbe. Pastaj shkova në shtëpinë e familjes së dajës tim në fshatin RadbravëAtje ndenja 8 ditë. Një mjek nga Krusha e Madhe... vinte çdo ditë në shtëpinë e dajës për të më mjekuar plagën...

.....

PP: Duke iu kthyer ngjarjes së Opterushës, a keni dëgjuar për sulmin që u krye nga UCK mbi atë fshat?

EK: Jo.

PP: Pra, po më thoni se, megjithëse jeni nga Opterusha, nuk keni dëgjuar për sulmin që ndodhi atje?

EK: E saktë.

PP: Pra, sipas asaj që po thoni, në Opterushë duhet të jetojnë ende serbë?

EK: Nuk e di.

PP: Por, a e dini nëse ata janë ende atje?

EK: Ata nuk janë më atje, por nuk e di pse.

.....

PP: Kur u plagosët, a ishit me uniformë?

EK: Po.

PP: Çfarë ngjyre?

EK: E zezë.

PP: A ka kjo ngjyrë ndonjë kuptim?

EK: Jo, në fakt uniformën e bleva vetë. Ne kishim vetëm distinktivë të UCK-së. Me fjalë të tjera, mbajtja e uniformës së zezë ishte zgjedhja ime, sepse më pëlqen kjo ngjyrë.

PP: A e njihni një person me emrin H.M?

EK: Po. E njoh si bashkë-fshatar.

PP: A ishte edhe ai pjesëtar i UCK-së?

EK: Nuk e di. Nëse ishte, nuk ishte me mua.

PP: A njihni njeri me emrin nga Opterusha?

EK: Po.

PP: A ishte një farë ... nga Opterusha me UCK-në?

EK: Jo

PP: Përveç jush, a ishte njeri tjetër nga Opterusha pjesëtar i UCK-së?

EK: ishte ndër të parët që u kyç dhe ishte gjithë kohën me mua. Po kështu.

PP: A janë ata gjallë?

EK: Jo, kanë vdekur të dy.

PP: Pra, ju njihni vetëm këta të dy të cilët kanë vdekur?

EK: Njoh të tjerë, por nuk ishin me mua.

PP: Më thoni me emrin e ndonjërit nga Opterusha i cili ishte ushtar i UCK-së nga Opterusha në korrik 1998.

EK: Nuk njoh njeri tjetër.

PP: Mendova se thatë se kur ishit në Drenovë atje ishin ushtarë të tjerë nga Opterusha. A nuk është e saktë?

EK: E vërtetë është, por nuk i dija emrat e tyre sepse ishin të rinj. Përveç kësaj, unë jetova larg Opterushës për ca kohë, isha në Zvicër për 5 vite dhe në Prishtinë, kështu që u shkëputa nga jeta e fshatit.”

Siç e sheh gjykata, është shumë e pamundur që E.K të mos ketë dijeni për sulmin në Opterushë, ose që ai mban mend vetëm emrat e ushtarëve të UCK-së të cilët tani kanë vdekur. Gjatë shqyrtimit kryesor, E.K deklaroi disa herë se ishte krenar për përfshirjen e tij në UCK dhe në luftën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ai është tani drejtuesi i shoqatës regjionale të veteranëve të UCK-së. Prandaj është e kuptueshme që ai dëshiron të mbrojë trashëgiminë e UCK-së dhe ushtarët e UCK-së, duke mos i përmendur ata në lidhje me sulmin në Opterushë.

Në këtë kuadër, gjykata i gjen deklaratat e tij me besueshmëri të dyshimtë. Kur merren parasysh deklaratat e besueshme të dëshmitareve D.B dhe S.B dhe të të pandehurit H.M dhënë në prokurori më 14 dhe 22 dhjetor 2010, dhe parë në lidhje me deklaratat e të pandehurve të tjerë, siç përmendet në vijim, gjykata gjen se deklaratat e dhëna nga i pandehuri E.K nuk janë të besueshme.

4. **Të pandehurit Mu.H, Mi.H, N.H, N.B dhe J.K** dëshmuan të gjithë në mbështetje të faktit se E.K u plagos rreth një muaj përpara se të ndodhte sulmi në Opterushë.
5. **I pandehuri Mu.H** kur dha deklaratën e tij si dëshmitar në prokurori në fshatin Rogovë më 23 shkurt 2011, deklaroi se nuk ka dëgjuar për sulmin mbi serbët në fshatin Opterushë në vitin 1998. Ai është gjithashtu i afërm i të pandehurit E.K.

Kur u pyet për kohën kur E.K u plagos, nga deklarata e këtij dëshmitari del si vijon:

...

Hetuesi: Kur ndodhi?

Dëshmitari: Mendoj se ndodhi ditën. Ishte përpara drekës.

Hetuesi: A ishte në 1998?

Dëshmitari: Ishte në verën e vitit 98.

Hetuesi: A ishte qershor, korrik, gusht apo shtator?

Dëshmitari: Mendoj se ishte korrik?

Hetuesi: Përse mendoni se ishte korrik?

Dëshmitari: Arsyeja kryesore është se mbaj mend se në atë kohë korrnim grurin. Ishte tamam koha rreth 10 korrikut.

Hetuesi: A mund të shpjegoni përse plagosja e E.Kt ka ndonjë lidhje me korrjen e grurit?

Dëshmitari: Sepse ishte koha e korrjes së grurit, që është ndërmjet 10 korrikut dhe 10 gushtit. Dhe kjo ndodhi në fillim të atij sezoni dhe jo në gusht. Mbaj mend se kishte plot njerëz rreth shtëpisë time në atë kohë sepse ishte koha për të korrur grurin.

...

Ai e dha deklaratën e tij si i pandehur para hetuesit më 14 mars 2011. Pastaj ai vërtetoi deklaratat e tij të 23.02.2011 në këtë mënyrë:

“IPO: A e konfirmoni në tërësi atë që keni deklaruar?”

MH: Po. Por dua të bëj vetëm një ndryshim: nuk e di ditën e saktë ngase ka kaluar kohë e gjatë. E di se ishte korrik, sepse po korrnim drithin. Nga fillimi deri në mes të korrikut.”

Deklaratës së tij dhënë në prokurori i qëndroi në gjykatë gjatë shqyrtimit kryesor.

Gjykata gjen me shumë pak gjasa që i pandehuri të mos ketë dëgjuar për sulmin e njohur mbi serbët në Oplotushë në korrik 1998, dhe e kupton mosdijen e deklaruar të tij si mënyrë për të mbrojtur trashëgiminë e UCK-së dhe luftën e drejtë për liri.

Si i afërm i të pandehurit E.K, gjykata e sheh më tej deklaratën e tij si përpjekje për të mbrojtur të afërmin e tij.

Megjithëse nuk ishte i sigurt për datën e saktë, i pandehuri është megjithatë i sigurt se E.K u plagos përpara mesit të korrikut, me fjalë të tjera përpara sulmit, sepse ishte në fillim të sezonit të korrjes së grurit. Megjithatë kjo është një që veprimtari që ndodh çdo vit, dhe gjykata e gjen pa gjasa që ai mund të mbante mend se kur ndodhi plagosja gjatë sezonit të korrjes së vitit 1998 – 13 vjet më parë.

Si përfundim, gjykata e gjen deklaratën e tij për kohën e lëndimit të E.Kt jo të besueshme.

Duke marrë parasysh sa më poshtë, ndikimin e të gjitha provave të dhëna, deklaratat e Mu.Ht para hetuesit lidhur me kohën kur E.K u plagos, përcaktohen të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm si të rreme.

6. I pandehuri **Mi.H** e dha deklaratën e tij si dëshmitar para hetuesit të EULEX-it në fshatin Rogove më 23 shkurt 2011, dhe deklaroi se E.K është daja i tij, por e jep deklaratën e tij vullnetarisht. Edhe ai është vëllai i të pandehurit Mu.H. Më tej ai deklaroi se nuk e di nëse E.K ishte pjesëtar i UCK-së kur u plagos, sepse kjo ndodhi shumë kohë më parë. Ai ndihmoi në transportimin e tij kur u plagos.

“Hetuesi: Kur ndodhi kjo?”

Dëshmitari: Siç i kemi punët tona, më 7 korrik 1998 pati ndërprerje të rrymës. Kompania elektrikut na tha se nuk do të na e kyçte rrymën nëse nuk do të paguanim para 11 korrikut, kështu që ne mblodhëm paratë.

“E u plagos më 11 korrik 1998. Jam i garantuar për këtë. E mbaj mend ditën sepse atë ditë duhej t’i dorëzoja paratë kolektorit të kompanisë elektrike. Pastaj shoku im i dha paratë kolektorit. Atë natë të 11 korrikut na erdhi rryma.”

Më 14 mars 2011 Mi.H vërtetoi deklaratën e tij të dhënë si dëshmitar para hetuesit të EULEX-it dhe e vërtetoi këtë në gjykatë gjatë shqyrtimit kryesor.

Duke marrë parasysh që i pandehuri E.K është daja i tij, gjykata e gjen të kuptueshme se ai dëshiron të mbrojë dajën e tij.

Arsyen e deklaruar përse ai e mbante mend kohën kur u plagos daja i tij, E.K, gjykata e gjen tepër të pazakontë dhe kësisoj jo të besueshme.

Kur merren parasysh të gjitha provat, sic u deklarua më lart dhe në vijim, gjykata i gjen deklaratat e Mi.Ht të dhëna në prokurori më 23 shkurt 2011 në fshatin Rugovë, lidhur me kohën kur u plagos E.K, si të rreme përtej dyshimit të arsyeshëm.

7. **I pandehuri N.H**, kur dha deklaratën e tij si dëshmitar në fshatin Rogovë më 3 mars 2011, deklaroi se ka dëgjuar fjalë për sulmin mbi shtëpitë e civilëve serbë në korrik 1998 në Oplotushë dhe se ishte pjesëtar i UCK-së, por jo nën komandën e E.Kt. Ai deklaroi se ndihmoi në transportimin e E.Kt të plagosur në shkollën e Radobravës ku e lanë.

Hetuesi: Kur ndodhi kjo?

Dëshmitari : Ditëlindja ime është më 11 qershor dhe kjo ndodhi më 11 korrik. Jam i sigurt për këtë. Mbaj mend se diskutova me njerëzit atje dhe thashë se vetëm para një muaji kisha pasur ditëlindjen dhe tani kjo.

Hetuesi: A pati ndonjë gjë tjetër të veçantë që ndodhi gjatë 11 korrikut 1998, që ju do ta mbanit mend?

Dëshmitari: Atë natë ruanim jashtë shtëpisë time dhe diskutova atje atë që kishte ndodhur.

Hetuesi: A pati rrymë gjatë 11 korrikut 1998 apo jo?

Dëshmitari: Vështirë të thuhet, sepse kisha nevojë për rrymë.

Hetuesi: Kë takuat në shkollë në Radobravë?

Dëshmitari: Nuk e di, sepse ne vetëm e lamë atje dhe u kthyem këtu.

Si i pandehur ai vërtetoi deklaratat e tij më 17 mars 2011

Gjykata nënvizon anëtarësinë e tij në UCK dhe e gjen këtë si gjasën më të madhe që ndikoi në deklaratat e tij si kuptim për të mbrojtur trashëgiminë e UCK-së. Më tej ajo i

gjen deklaratat e mësipërme tepër të pazakonta dhe të dyshimta lidhur me faktin përse ai e mbante mend datën e saktë kur u plagos E.K. Kur merret parasysh totali i provave të dhëna, gjykata gjen përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e tij para hetuesit të EULEX-it më 3 mars 2011 në fshatin Rugove, se kur u plagos E.K, është e rreme.

8. **I pandehuri N.B**, kur dha deklaratën e tij si dëshmitar në prokurori më 3 mars 2011, në Rogove, deklaroi se ishte pjesëtar i UCK-së nga prilli 1998 dhe se ai takoi të pandehurin E.K kur u plagos ky i fundit, por pas luftës ai e takoi më shpesh E.Kn. Kur u pyet për kohën kur u plagos E.K, nga deklaratat e dhëna u mor sa vijon:

“Hetuesi: Kur ndodhi gjithë kjo që E.K u plagos dhe ju e ndihmuat?”

Dëshmitari: Ishte java e parë e Korrikut 1998. Ishte 10 ose 11 korrik.

Hetuesi: Si ka mundësi që ju e mbani mend datën me kaq saktësi?

Dëshmitari: E mbaj mend, sepse Rahoveci u vendos nën sulmin e forcave serbe . Ky sulm ishte më 17 ose 18 korrik 1998. Mbaj mend që E u plagos rreth 1 javë më përpara 17 ose 18 korrikut.

Hetuesi: Sa i sigurt jeni për këtë?

Dëshmitari: Jam 100 % i sigurt sepse u plagosa 2 ose 3 ditë më vonë se kur u plagos E.K.

Hetuesi: A është regjistruar në ndonjë mënyrë se ju jeni plagosur?

Dëshmitari: Kjo ishte nën rrethana të vështira, prandaj nuk mendoj se u bë ndonjë regjistrim. Sidoqoftë, unë u mjekova nga mjekë 2-3 javë pasi u plagosa.

Hetuesi: A e dini se duhet të tregoni të vërtetën? Përndryshe mund të akuzoheni. A jeni ende i sigurt për datën?

Dëshmitari: Po jam. Nuk gënjej. Mbaja ditar.

Hetuesi: A mund ta shoh ditarin, ju lutem?

Dëshmitari: Jo, nuk e kam.

Hetuesi: Ku është ditari?

Dëshmitari: E mbaja ditarin në shtëpi dhe shtëpia u dogj nga serbët. Ishte në prill 1999.

Hetuesi: A u përfshi E.K në luftimin në Opterushë?

Dëshmitari: Nuk e di.

....”

Më 17 mars N.B u mor në pyetje si i pandehur dhe vërtetoi deklaratat e tij të dhëna si dëshmitar.

Gjykata vëren se i pandehuri ishte ushtar i UCK-së dhe kuptohet se dëshiron të mbrojë trashëgiminë e UCK-së dhe të shokut të tij ushtar të UCK-së, E.K, të cilin ai e takoi për herë të parë kur u plagos “J” dhe që atëherë e ka takuar më shpesh. Siç e sheh gjykata, kjo ul besueshmërinë e deklaratave. Po kështu, gjykata e gjen disi të pazakontë që ai mban mend vetëm kohën e lëndimit të E.Kt, ndërkohë që është pothuajse i pasigurt kur u pyet të jepte data.

Duke marrë parasysh se totali i provave shpie në përfundimin se i pandehuri E.K ka marrë pjesë në sulmin në Operushë më 17 dhe 18 korrik 1998, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e dhëna nga N.B para prokurorit të EULEX-it më 3 mars 2011 në Rogovë lidhur me kohën kur u plagos E.K, ishin të rreme.

9. **I pandehuri J.K** kur dha deklaratën e tij në prokurori si dëshmitar më 8 shkurt 2011 në Prishtinë, pranon se ka marrëdhënie shumë të mira me të pandehurin E.K dhe se nuk është dakord që dikush sulmoi shtëpitë e serbëve në korrik 1998 në Operushë. Ai deklaroi gjithashtu se ishte pjesëtar i UCK-së nga maji ose qershori 1998 dhe ishte një lloj drejtuesi dhe se E.K operonte në fshatin e tij, që ishte Operushë, dhe se u përfshi në një betejë bashkë me E.Kn kundër forcave serbe në fshatin Rogovë, dhe ishte me E.Kn kur u plagos dhe e dërgoi E.Kn e plagosur në spitalin e UCK-së Garjak në zonën e Suharekës.....

Për më tepër hetuesit i deklaroi *ndër të tjera* kështu:

.... Kam vështirësi me emrat dhe datat. por ishte në fund të korrikut ose në fillim të gushtit. Kur filluan të luftojnë kundër njëri-tjetrit ishte të paktën 20-25 ditë pasi E ishte plagosur.

Hetuesi: Kur e patë En përsëri?

Dëshmitari: Mendoj se e pashë rreth Randubravës rreth 10 ditë më pas. Dëgjova se ai lëvizti nga fshati Garjak në Rundubravë.

Hetuesi: Në çfarë gjendjeje ishte?

Dëshmitari Gjendja e tij ishte pak më mirë se kur u largova prej tij. ishte shtrirë në një krevat, por ai u përpoq të çohet dhe të përshëndeste.

Hetuesi: Çfarë date ishte?

Dëshmitari: Të gjitha këto gjëra ndodhën në korrik. Ai u plagos në fillim të korrikut. Unë e takova në mes të korrikut dhe luftimi ndodhi në fund të korrikut ose fillim të gushtit 1998....”

Më 21 shkurt intervista vazhdon:

“...Hetuesi: Çfarë date ishte kur ishit në betejë me E.Kn dhe ku E.K u plagos?

Dëshmitari: Nuk më kujtohet data. Me sa më kujtohet ishte në fillim të korrikut 1998. Nuk jam i sigurt për datën.

Hetuesi: Sa i sigurt jeni për datat?

Dëshmitari: Jam më se 50 për qind i sigurt se E.K u plagos në fillim të korrikut 1998.

Hetuesi: Si ka mundësi që e mbani mend se ishte fillimi i korrikut 1998?

Dëshmitari: Në fund të qershorit, rreth datave 25-27, policia serbe më rrahu keq. Besoj se ky incident me E.Kn ndodhi rreth 1 javë më pas. ..”

Më 8 mars 2011 J.K u mor në pyetje përsëri dhe vërtetoi deklaratat e tij të 8 shkurtit.

Më 15 mars 2011 ai u mor në pyetje si i pandehur dhe vërtetoi deklaratat e mëhershme të tij, këtë e mbrojti edhe në gjykatë gjatë shqyrtimit kryesor.

Gjykata nuk e gjen të besueshme lidhur me kohën e ngjarjeve. I pandehuri është i sigurt se E.K u plagos në fillim të korrikut, por arsyeja e dhënë nuk është e besueshme.

Po kështu, gjykata thekson marrëdhëniet e tij me E.Kn dhe anëtarësinë e tij në UCK. Prandaj është e kuptueshme se ai dëshiron të mbrojë trashëgiminë e UCK-së dhe shokun dhe ish bashkë-luftëtarin pjesëtar të UCK-së.

Në këtë kuadër, gjykata e gjen dëshminë e tij të dyshimtë.

Kur merret parasysh totali i provave, pjesët kryesore të të cilave përmenden më lart ose në vijim, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se deklaratat e të pandehurit J.K të dhëna para hetuesit të EULEX-it në Prishtinë më 8 shkurt 2011 lidhur me kohën kur u plagos E.K, janë të rreme.

10. Dëshmitari **P.M**, kur dha dëshmi para hetuesit të EULEX-it më 13 Janar 2011 deklaroi se ishte a pjesëtar i UCK-së nga vjeshta 1998.

Hetuesi: A e dini nëse E.K u plagos gjatë luftës?

Dëshmitari: Nuk e di. Dëgjova se u lëndua por nuk e di ku ose kur.

Hetuesi: A mund të jetë plagosur përpara sulmit mbi shtëpitë e serbëve?

Dëshmitari: Jo, me siguri jo. Duhet të ketë qenë më vonë.

Në gjykatë dëshmitari deklaroi se nuk e dinte.

Gjykata ka dyshime për shpjegimet e dëshmitarit në gjykatë se ai nuk e dinte ose se ishte gabim në përkthim. Po kështu, gjykata nuk gjen arsye përse ai duhet ta deklarojë këtë, nëse nuk ishte e vërtetë. Për rrjedhojë, gjykata e gjen të besueshme deklaratën e mësipërme dhënë hetuesit të EULEX-it, domethënë, që Ka nuk u plagos përpara sulmit.

11. Dëshmitari A.H

Dr. H. mjekoi të pandehurin e plagosur, E.K, në spitalin fushor të UCK-së. Deklaratat e tij në shqyrtim kryesor ishin dukshëm më të pasigurta se deklaratat e mëparshme dhënë hetuesit të EULEX-it më 21.12.2010. Gjykata i gjen deklaratat e tij në hetuesi më të besueshme, sepse kupton se deklaratat e tij në shqyrtim kryesor ishin nën presionin e ngurrimit për të dëshmuar kundër pjesëtarëve të UCK-së, veçanërisht të pandehurit E.K. Gjykata nuk gjen arsye përse ai duhej t'i deklaronte hetuesit diçka që nuk ishte e vërtetë. Për këtë arsye, deklarata e tij në gjykatë nuk konsiderohet e besueshme, si deklarata e tij dhënë hetuesit të EULEX-it më 21.12.2010.

Në hetuesi më 21.12.2010:

“.....

Hetuesi: A e regjistruat ju ose stafi juaj çdo pacient.

Dëshmitari: Mund të them se 95 % e pacientëve ishin të regjistruar. Por kur ishim në raste shumë urgjente nuk arrinim të regjistronim çdo njeri. Këtë sistem që përdora e krijova vetë.

.....

Hetuesi:.....A e gjetët atë (E.Kn) në këto shkresa.

Dëshmitari: Po. Megjithëse fillimisht nuk më kujtohej që kisha pasur një pacient për 2 javë, por gjeta regjistrimin e vetëm të disponueshëm për këtë pacient. Dhe ju mund të përcaktoni me lehtësi se regjistri i tij është kopje e origjinalit. Ky regjistër është dokument që është i vetmi dokument i disponueshëm për të regjistruar informacionin bazë për pacientët. Nga shkresa që ju dorëzova sot, datat fillojnë më 4 gusht 1998 dhe përfundojnë në 1 shtator 1998. Çdo faqe është e ndarë në 4 kolona. Kolona e parë është numri i pacientit. Kolona e dytë është emri dhe shënimet personale të pacientit. Kolona e tretë është diagnoza dhe kolona e katërt është trajtimi. Nuk mund të mbanim ndonjë libër tjetër.

Hetuesi: A mund ta përshkruani regjistrimin lidhur me E.Kn?

Dëshmitari: Data e regjistrimit është 12 gusht 1998. Numri i pacientit ose protokollit është 1199. Emri është E.K. Viti i lindjes 1965. Vendi i lindjes është Opterushë. Diagnoza është

shënuar në latinishte si: "Vulnus Sclopetorium, Regio Lat. Dex", që do të thotë plagë nga armë zjarri në anën e djathtë. Po të jemi të saktë, duket se ndihmësi im mund të mos më ketë ndjekur me saktësi për vendndodhjen e saktë të lëndimit në trup. Po t'i referohem asaj që është shkruar, nuk është plotësisht e qartë ku ishte lëndimi. Kolona numër 4, trajtimi i përshkruar ishte vetëm për 4 ditë terapi, d.m.th. se ai mori mjekim për 4 ditë. Ishte injeksion penicilinë dhe 4 ditë gentamicinë. Jam më se i sigurt duke përdorur logjikën time se nëse do të kishte qenë në spital për 2 javë, do ta kisha mbajtur mend. Po t'i referohem protokollit me lëndimet e tij, me shumë gjasa ai ndenji në spital maksimumi 1 ose 2 ditë. Por është bindja ime nga kjo shkresë se ai ishte vetëm një pacient i jashtëm për 1 ditë. Ishte pacienti i trembëdhjetë në atë datë.

Hetuesi: Pra, për qartësi, ky regjistrim për 12 gushtin 1998. është i vetmi dokument që keni për mjekimin e E.Kt ndonjëherë?

Dëshmitari: Jam 99 % i sigurt se ky është i vetmi regjistrim që kam për E.Kn. Mund të ketë një përjashtim por nuk mendoj kështu.

Hetuesi: Për mendimin tuaj më të mirë, a e mjekuat E.Kn në korrik 1998 për plagë me armë zjarri?

Dëshmitari: Unë nuk kam asnjë regjistrim tjetër për të dhe nuk e mbaj mend. Mund vetëm t'i referohem këtij dokumenti zyrtar.

Hetuesi: Cilit spitali i referohet ky regjistrim?

Dëshmitari: Ishte Breshance. Largësia ndërmjet Breshances dhe Gajrakut është afërsisht 7 ose 8 km.

Hetuesi: A e njihni fshatin Rugovë e Hasit.

Dëshmitari: Po.

Hetuesi: Sikur dikush të lëndohej në këtë fshat, ku do ta kishin dërguar?

Dëshmitari: Zakonisht kudo të ishte e mundur, por vetëm nga atje. Nuk kishte vende të tjera ku të shkonte. Njerëzit vinin nga të gjitha anët, edhe nga distanca të largëta.

Hetuesi: Pra, megjithëse ju lëviznit nga një qendër në tjetrën të lënduarit shkonin atje ku do të ishit ju?

Dëshmitari: Po, ata pyesnin ku isha dhe vinin tek unë. Për një farë kohe, unë kisha të vetmen qendër mjekësore që operonte në Kosovë. Madje disa shënime në këtë dokument u referohen disa pacientëve nga Prishtina.

Hetuesi: A keni dokument të ngjashëm për korrikun 1998.

Dëshmitari: Po, mund t'jua jap edhe juve. Në të nuk ka shënim për E.Kn për korrikun 1998. Por duke e parë, e di se isha në Gajrak në atë kohë.

Hetuesi: Duke parë shkresën që keni për E.Kn, a mund të thoni se kur e mori lëndimin?

Dëshmitari: Jo, nuk mund ta them këtë, nuk ishim në gjendje të mbanim kaq shumë detaje. Kjo shkresë tregon se me më shumë gjasa ai ka qenë pacient i jashtëm atë ditë. Meqenëse po kërkoni detaje konkrete, nuk mund të them me saktësi se kur e mori lëndimin, por siç thashë nuk kam shkresë për E.Kn më 11 ose 12 korrik 1998.....”

Sipas deklaratave të E.Kt, ai u shtrua në spital për 2 javë pas plagosjes me armë. Sipas dëshmisë së dr. A.Ht, ai me shumë gjasa do ta kishte mbajtur mend E.Kn po të kishte ndodhur kështu. Megjithatë, dr. H. nuk kujtoi që E.K të ishte shtruar në spital kur ishte plagosur.

Bazuar në këtë, dhe në pjesën tjetër të deklaratave të dëshmitarit, të dhëna në shqyrtimin kryesor ose para hetuesit më 21.12.2010, gjykata nuk gjen prova të besueshme se E.K u plagos, siç u deklarua nga ai, më 11 ose 12 korrik 1998. Përkundrazi, bazuar në të njëjtat prova të lart-përmendura nga dr. A.H, gjykata e gjen të mundshme që E.K u plagos në fund të korrikut/fillim të gushtit 1998, që është pas sulmit.

Gjykata vëren, megjithatë, se ka disa pasiguri për mjekimin që mori i pandehuri E.K, në veçanti nëse u shtrua në spital apo jo.

Megjithatë, siç e sheh gjykata, kjo pasiguri nuk ka pasojë të ndjeshme në faktin nëse E.K u plagos para apo pas sulmit më 17 dhe 18 korrik 1998.

12. Dëshmitari N.M,

Kur dëshmoi para hetuesit të EULEX-it më 19.01.2011, ai deklaroi ndër të tjera si vijon:

“....

Hetuesi: A e njihni E.Kn?

Dëshmitari: Jemi nga i njëjti fshat. E kam njohur që kur ishte djalë. Ai është rreth 20 vite më i ri se unë.

Hetuesi: A kishte ai ndonjë gradë?

Dëshmitari: Ishte komandant i UCK-së në Opterushë në atë kohë kur serbët u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Ka shkollim të mirë.

....”

Gjykata nuk sheh arsye përse dëshmitari duhet të japë deklaratë të rreme, ose keqkuptim, për të lart-përmendurën, dhe për rrjedhojë e gjen deklaratën e tij të besueshme. Deklaratat e tij në shqyrtimin kryesor janë ndryshuar ndjeshëm dhe janë

shumë më të pasigurta. Gjykata e kupton këtë si përpjekje të dëshmitarit për të mbrojtur dhe ndihmuar të pandehurin E.K dhe prandaj i gjen këto deklaratat më pak të besueshme se deklaratat e mëparshme të cituara më lart para hetuesit të EULEX-it.

13. Deklaratat e dëshmitarit F.M,

të dhëna në shqyrtim kryesor ose para hetuesit të EULEX-it, nuk japin ndonjë provë vendimtare për kohën kur u plagos E.K, siç e sheh gjykata.

14. Nga ana tjetër,

Gjykata u referohet deklaratave të **dëshmitareve D.B dhe S.B**, të cilat deklarojnë të dyja se e panë “Jn” në radhët e ushtarëve në oborr pasi serbët u dorëzuan në mëngjesin e 18 korrikut. Po kështu, dëshmitarja D.B deklaroi se bashkëshorti i saj dëgjoi zërin e “Js” natën e 17 korrikut që e paralajmëroi bashkëshortin e saj të mos dilte jashtë, pak para se të fillonin të shtënat.

Po kështu H. M në deklaratën e tij në prokurori më 14 dhjetor 2010, shpjegoi se takoi E.Kn në Operushë pak para se të niste sulmi më 17 korrik dhe se E.K nuk dukej i plagosur në atë kohë.

Gjykata i gjen të besueshme deklaratat e dëshmitareve D.B dhe S.B për këtë çështje. Në lidhje me këtë, gjykata vë në dukje deklaratat e ngjashme të tyre në këtë drejtim, që gjykata i gjen edhe të logjikshme. Për më tepër, ato kanë qenë konsistente në deklaratat e tyre gjatë hetimit dhe shqyrtimit kryesor. Po kështu, gjykata i gjen të besueshme deklaratat e të pandehurit H.M në prokurori më 14 dhjetor 2010, që ai e takoi E.Kn dhe foli me të më 17 korrik në Operushë, e besueshme.

Gjykata nuk sheh arsyet se perse deklaratat e lartcekur duhet të jete falso apo të mos reflektoj ajo që ka ndodhur në fakt.

Në këtë sfond, gjykata e gjen të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se E.K nuk ishte plagosur para 17 korrik 1998 dhe se ai ishte i pranishëm dhe ka marrë pjesë në sulmin mbi shtëpitë serbe në 17 dhe 18 korrik 1998 në Operushë siç u tha në akuzë kundër tij.

Rrjedhimisht deklaratat e të pandehurve të tjerë Mu.H, Mi.H, N.H, N.B dhe J.K janë gjetur falso se kur i pandehuri E.K u plagos përtej dyshimit të arsyeshëm.

15.A ishte H.M anëtar i UCK-se?

Në deklaratat e tij në prokurori e cila u mbështet në gjykatë të hapur, H.M nuk ka pranuar se është anëtar i UÇK-së. Ai megjithatë në këto raste, shpjegoi se ai kishte një lloj rol mbrojtës në lagje.

Megjithatë në deklaratën e tij në prokurori on 14 dhe 22 dhjetor 2010 siç citohet më sipër, i pandehuri H.M tha mes tjerash se ai ishte anëtar UÇK-së, se ai ishte në Opterushe në 17 korrik 1998 dhe se njësitë speciale të UÇK-së nga rajoni i Drenicës arritën në fshat, duke sjell urdhër për të sulmuar serbët që jetojnë në Opterushe. Ai më tej deklaroi se ai u përpoq të bindte komandantin e UÇK- se për të mos nisur sulmin, por ai nuk mund të pengojë atë. I pandehuri Ma po ashtu ka deklaruar se ushtarët e UÇK-së në një pikë hapën zjarr kundër familjeve serbe në Opterushe.

Në të njëjtin rast i pandehuri H.M ka deklaruar se ai ishte një marangoz dhe kishte instaluar dyert në shtëpi të Bo. Ai gjithashtu theksoi vizitën e tij në shtëpinë Bo disa ditë para sulmit që filloi më 17 korrik 1998. H.M më tej theksoi se në korrik 1998 ai ishte anëtar UÇK-së dhe se ai kryesoi ose koordinoi një grup ushtarësh, më të afërmit të tij, në Opterushe.

Në lidhje me këtë dëshmia e te pandehurit H.M në pikat kryesore konfirmon dëshmitë e dëshmitarëve Bo. D dhe S.B.

Gjykata nuk sheh ndonjë arsye pse të pandehurit duhet të dhënë dëshmitë e rreme në fillim të hetimit duke konfirmuar dëshmitë e dëshmitarëve Bo. D dhe S.B.

Nga ana tjetër, gjykata gjen arsye të mirë pse ai duhet të japë më vonë një version tjetër duke mohuar pjesëmarrjen e tij në sulm. Duke mohuar deklaratat e tij ne prokurori me 14 dhjetor 2010, ai sigurisht është duke u përpjekur të mos e njollosojë rolin e UÇK-së në luftën e drejtë për pavarësi dhe liri për Kosovën. Ai nuk do të marrë pjesë në atë që është kuptuar sikurse vënia e fëlliqësirës mbi UÇK-në ose ushtarëve që luftonin në UÇK. Në këtë sfond ai mohon dëshminë e tij të 14 dhjetor 2010 tek prokurori, sipas gjetjes se gjykatës.

Bazuar në këtë gjykata e gjen të besueshme deklaratat e dhëna tek prokurori më 14 dhjetor 2010 nga i pandehuri H.M.

Në përfundim gjykata konstaton se në këtë mënyrë i pandehuri H.M ishte anëtar UÇK-së në korrik 1998, duke përfshirë edhe kohën e sulmit në Opterushe më 17 dhe 18 korrik 1998.

16.Në konkludim

Gjykata gjene se deklaratat e dëshmitarëve D.B janë meritore dhe te besueshme sipas dijenisë se saj dhe identifikimit të të pandehurve E.K dhe H.M dhe se te dy ishin prezent ne oborrin e shtëpisë se dëshmitarëve ne mëngjes te 18 Korrikut 1998.

Gjykata nuk ka problem ne besimin e deklaratave nga dëshmitarët se te dy E.K dhe H.M ishin te armatosur me pushka gjate sulmit, pavarësisht nga tentimi fillestar dhe pasigurisë nga dëshmitarët. Edhe pas marrjes ne pyetje nga avokati mbrojtës, ajo ia arriti te ruaj këtë.

